



21 MAJ 2015

RRETH INCIDENTEVE TË FUNDIT NË KLINË DHE PROCESIN E NGADALSHËM TË KTHIMIT

Në natën ndërmjet 17-18 majit, disa qytetarë serbë të cilët ishin kthyer kohët e fundit në fshatrat Binçë dhe Grapç në komunën e Klinës, janë raportuar të kenë qenë viktimë të një sërë vjedhjeve dhe abuzimeve verbale nga sulmues të panjohur.¹ Këto janë disa nga rastet më të fundit që vijnë si shtesë në një numër incidentesh të ngjashme që kanë përfshier të kthyerit serbë në komunën e Klinës. Policia e Kosovës është duke hetuar këto incidente.² Ngjarje të kësaj natyre, edhe pse jo gjithmonë të motivuara etnikisht, janë të patolerueshme dhe krijojnë një atmosferë frike dhe pasigurie tek qytetarët serbë të Kosovës dhe veçanërisht tek të kthyerit në komunën e Klinës dhe të kthyerit gjetiu në Kosovë.

Incidentet që kanë përfshier pjesëtarët e komunitetit serb menjëherë kanë ngritur pyetjet dhe interesin qytetarë mbi motivin që ka shtyer te këto incidente. Edhe pse pjesa më e madhe e incidenteve janë krime të vogla dhe nuk kanë përfshier veprime të dhunshme, numri relativisht i lartë i incidenteve në fshatrat e komunës së Klinës që kanë përfshirë të kthyerit serbë mund të jenë një shenjë e marrëdhënieve të brishtë ndëretnike dhe e një situatë të paqëndrueshme të sigurisë.³ Rexhë Berisha, Komandanti i Stacionit Policor në Klinë, ka theksuar se qytetarët serbë në zonën e tij të përgjegjësishë kanë qenë objektiv apo synim në rreth 14 incidente gjatë vitit 2015, ndërsa për të njëjtën periudhë kohore ka pasur rreth 200 incidente në të cilat janë përfshier pjesëtarë të komunitetit shiptarë. Ai vuri në dukje se shkalla e krimeve që janë shqyrtuar dhe zgjidhur ku janë përfshier pjesëtarët e komuniteteve ka qenë rreth 60%, ndërsa shkalla e krimeve të zgjidhura ku janë përfshier pjesëtarë të komunitetit shumicë ka qenë rreth 75%.⁴ Kryetari i Klinës, zt Sokol Bashota; ka dënuar ashpër incidentet dhe ka shprehur mbështetjen e tij të plotë për pjesëtarët e komunitetit serb në komunën e tij.⁵ Për më tepër, ai gjithashtu i bëri thirrje Policisë së Kosovës dhe autoriteteve përkatëse për të identifikuar ata që janë përgjegjës dhe për të ndëshkuar ata me një denim, siç të parashikuar me ligjet përkatëse, për krimet e kryera.⁶ Në një intervistë dhënë RTK-së, qytetarët serbë viktimë të sulmit, kanë thënë se ata nuk i shohin

¹ http://kossev.info/strana/arhiva/klina_napad_i_kradja_u_selu_grabac/4913;

http://kossev.info/strana/arhiva/objiene_kuce_povratnika_u_selu_bica_kod_kline/4914;

<http://www.gazetaexpress.com/lajme/familjet-serbe-ne-kline-cak-i-vjedhjevemohohen-arsyet-etnike-video-101827/>

² <http://www.gazetaexpress.com/lajme/familjet-serbe-ne-kline-cak-i-vjedhjevemohohen-arsyet-etnike-video-101827/>

³ http://kossev.info/strana/arhiva/klina_napad_i_pljacka_povratnika/4858;

http://kossev.info/strana/arhiva/povratnik_iz_kline_tukli_me_psovali_traze_da_prodam_kucu/4873;

http://kossev.info/strana/arhiva/upad_u_kucu_povratnika_u_drniku_kod_kline/4698;

http://kossev.info/strana/arhiva/opljackana_kuca_srpskinje_u_selu_dugonjevo_kod_kline/4267; <http://lajmi.net/sulmohet-nje-serb-i-kthyer-ne-kline/>

<http://lajmi.net/sulmohet-nje-serb-i-kthyer-ne-kline/>

⁴ <http://www.gazetaexpress.com/lajme/familjet-serbe-ne-kline-cak-i-vjedhjevemohohen-arsyet-etnike-video-101827/>

⁵ <http://koha.net/?id=9&l=57088>

⁶ <http://live.kallxo.com/sq/MTL/Vendore-e-Nderkombetare-Reagojne-Ndaj-Incidenteve-me-Familjet-Serbe-ne-Kline-6666>

grabitësit si shqiptarët ose serbë, por thjeshtë si kriminelë. Situata në fshatrat e banuara me serbë është e qetë, dhe qytetarët serbë duket se do të përcaktohen për të qëndruar në Kosovë.⁷

Zyrtarët të qeverisë së Republikës së Serbisë ende nuk kanë lëshuar asnjë deklaratë në lidhje me incidentet e kohëve të fundit. Shefi i Zyrës së Qeverisë së Serbisë për Kosovën, Marko Gjuriç, kohë më parë ka vizituar të kthyerit serbë në komunën e Klinës dhe i kishte bërë thirrje autoriteteve të Kosovës që të sigurojnë mbështetje dhe ndihmë për serbët në nevojë meqë "ata janë në situatën më të pafavorshme në Kosovë".⁸ Ministri i punëve të jashtme të Serbisë, Ivica Daçiç, duke folur kohët e fundit në cilësinë e tij si kryetar i rradhës i OSBE-së, në përgjithësi ka folur për gjendjen e sigurisë në Kosovë duke e cilësuar pozitën e komuniteteve pakicë si "të papranueshme".⁹ Mediet në Serbi rregullisht kanë raportuar për incidentet dhe në përgjithësi i kanë përshkruar ato si incidente të motivuara etnikisht.¹⁰

Incidentet e kësaj natyre është vështirë për t'i kategorizuar sepse ato nuk janë gjithmonë të motivuara nga përkatësia etnike e atyre që janë përfshirë në incidente. Megjithatë, fakti që këto plaçkitje janë të fundit në një seri incidentesh që në shënjestër kanë pjesëtarë të komuniteteve pakicë – më konkretisht të qytetarëve të kthyer pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës, e bën të qartë se ekziston një mungesë reale e sigurisë për komunitetet pakicë në komunën e Klinës. Kjo e komplikon edhe më tej situatën e ndërlikuar dhe të brishtë në të cilën pjesëtarët e komunitetit serb gjejnë veten në këtë komunë, dhe duhet të merret seriozisht nga autoritetet përkatëse komunale dhe ato qendrore.

Në këtë drejtim, një reagim i shpejtë dhe një komunikim nga ana e politikanëve që përfaqësojnë komunitetin, përfaqësuesit përkatës të Policisë së Kosovës, si dhe nga kryetari i komunës së Klinës, do të ishin hapa të mirë në drejtimin e duhur që do të demonstrojnë se institucionet dhe mekanizmat e Republikës së Kosovës që janë themeluar për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve dhe për të korrigjuar shkeljet që u bëhen këtyre të drejtave janë të gatshëm për të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur të drejtat dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve, duke përfshirë edhe ato të komuniteteve pakicë. Zbardhja e rasteve, kapja dhe dënimi i personave përgjegjës për rastet e fundit të plaçkitjeve do të ishte hapi tjetër në drejtimin e duhur me qëllim të parandalimit të këtij lloji të incidenteve që të mos ndodhin në të ardhmen. Ndërsa është për ta lavdëruar që zyrtarët publikë, përfshirë ministra dhe kryetarin e komunës kanë lëshuar komunikatat duke dënuar incidentet dhe duke i bërë thirrje autoriteteve përgjegjëse që të zbardhin rastet dhe personat përgjegjës të kapen dhe të ndëshkohen në përputhje me rrethanat. Zyrtarët komunalë dhe ata të nivelit qendror duhet të kenë një qasje më proaktive kur angazhohen me pjesëtarët e komuniteteve pakicë, duke përfshirë edhe vizitat shtëpive të viktimave të sulmeve dhe grabitjeve të fundit. Deklaratat e tyre të shprehura përmes të cilave ata dënojnë aktet vandale të kohëve të fundit nuk janë të mjaftueshme, veçanërisht për viktimat dhe komunitetin serb, të cilët ndjehen veçanërisht të pambrojtur në këtë komunë.

Incidentet e fundit sjellin përsëri në vijën e pare politike problemet më të gjera që rrethojnë procesin e kthimit të personave të zhvendosur në Kosovë. Në një reagim të menjëhershëm, Ministri për komunitete dhe kthim, Dalibor Jevtiq; ka thënë se të kthyerit serbë në këtë pjesë të Kosovës dhe në pronat e tyre janë objektiv i vazhdueshëm për sulme, dhe se thirrjeve për zbardhjen e rasteve dhe sjelljen e kryesve të krimeve para drejtësisë nuk u është kushtuar

⁷ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=04&dd=29&nav_id=986235 or <http://www.gazetaexpress.com/lajme/familjet-serbe-ne-kline-cak-i-vjedhjevemohohen-arsyet-etnike-video-101827/>

⁸ http://www.rtvpuks.com/vesti/djuric_zatrasio_zastitu_srba_u_metohiji_/4875

⁹ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=05&dd=19&nav_category=11&nav_id=993614

¹⁰ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=04&dd=29&nav_id=986235 or <http://www.vesti.rs/Hronika/NAPADNUT-SRBIN-U-KLINI-Osamario-ga-nepoznati-Albanac.html> or <http://www.novosti.rs/vesti/srbija.73.html:548723-Klina-Surovo-prebijen-i-opljackan-stari-bracni-par>

vëmendje e madhe nga autoritetet.¹¹ Më 15 maj, Qeveria e Kosovës ka themeluar Grupin ndërministror për kthimin me iniciativën e Ministrisë për komunitete dhe kthim me qëllim përshtetimin e procesit të kthimit dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë.¹² Jevtiq ka thënë se mbetet me shpresë se Grupi i sapo-formuar ndërministror për kthim do të sjellë një ndryshim pozitiv në procesin e kthimit; vetëm rreth 10% e jo-shqiptarëve që kanë lënë Kosovën janë kthyer që nga viti 1999.¹³ Ky Grup i ri ndërministror u formua si pjesë e strategjisë së re të Ministrisë për komunitete dhe kthim, e cili u zhvillua me ndihmën dhe asistencën ECMI Kosovës.

Strategjia për komunitete dhe kthim, e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në dhjetor të vitit 2013 dhe për periudhën 2014-2018, synon të mbështesë procesin e kthimit të personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe për të mbështetur personat e zhvendosur dhe institucionet e Kosovës drejt ri-integrimit dhe stabilizimit të tyre të suksesshëm në shoqërinë e Kosovës.¹⁴ Korniza ligjore e Republikës së Kosovës dhe marrëveshjet dhe instrumentet e aplikueshme ndërkombëtare garantojnë të drejtën e kthimit për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë, që janë zhvendosur para dhe pas vitit 1999. Megjithatë, procesi i kthimit ka qenë i ngadalshëm dhe i vështirë. Ekziston një mungesë e të dhënave të sakta për personat e zhvendosur, mungesa e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies së pamjaftueshme sociale, pak vende pune dhe mundësi për të gjeneruar të ardhura, mungesa e infrastrukturës dhe e shërbimeve të tjera shoqëruese, etj.¹⁵ Strategjia 2014-2018 ka për qëllim për të kapërcyer disa prej këtyre vështirësive përmes koordinimit më të mirë me zyrat komunale për komunitete dhe kthim, dhe rritjen e përqëndrimit tek zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës, duke ofruar strehim dhe asistencë socio-ekonomike për të kthyerit më në nevojë, nëpërmjet ofrimit të përmirësuar të shërbimeve për të kthyerit, duke përfshirë kujdesin shëndetësor dhe arsimin, si dhe një numër të veprimeve të tjera të parashikuara në Strategji. Për më shumë informacion dhe një vlerësim të procesit të kthimit në Kosovë, ju lutem shikoni Raportin e ECMI Kosovës [*Procesi i riatdhesimit në Kosovë: organizimi institucional, korniza ligjore, mësimet e nxjerra dhe sfidat që mbeten.*](#)

Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:

[Dita memoriale e goranëve më 6 maj: Një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës](#)

14 maj, 2015

[Me rastin e incidentit të fundit në Pasjan](#)

10 maj, 2015

[Buxhetet e komunave veriore të Kosovës: Marrëveshje më në fund](#)

7 maj, 2015

[Incidentet dhe tensionet në Mitrovicë: Nevoja për raportim objektiv dhe forcim të sundimit të ligjit](#)

21 prill, 2015

¹¹ <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=1655>

¹² <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=1598>

¹³ Ibid.

¹⁴ http://www.mkk-ks.org/repository/docs/Strategy_January_2014.pdf

¹⁵ Ibid.

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)

16 prill, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv I bazuar në përkatësinë etnike?](#)

31 mars, 2015

[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)

10 mars, 2015

[Deklarata kontroverze e Ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)

5 mars, 2015

[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

22 shkurt, 2015

[Një sistem juridik dhe gjyqësor i unifikuar në Kosovë?](#)

15 shkurt, 2015

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

8 shkurt, 2015

[Thirrje për arsye dhe veprim në prag të protestave në Prishtinë](#)

25 janar, 2015

[Farkimi i një mjedisi pune në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

19 janar, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë dhe i bën thirrje autoriteteve në Kosovë që të sigurojnë qasje të lirë dhe të papenguar në objektet e kultit](#)

7 janar, 2015

[The Formimi i qeverisë së re të Kosovës, përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe sfidat në të ardhmen](#)

10 dhjetor, 2014

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.